



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 35

Tiranë – E hënë, 7 mars 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 10/2016 datë 11.2.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar..... 2637
Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr. 1, datë 4.2.2016	Për përcaktimin e buxhetit e të drejtimeve prioritare të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve dhe kalendarit të programeve të financimit, për vitin 2016..... 2641
Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr. 8, datë 4.2.2016	Për detyrat dhe funksionimin e sekretariateve teknike për administrimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve..... 2643
Udhëzim i ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 19.2.2016	Mbi zbatimin e vendimit nr. 758, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave për ngarkimin e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për këtë ministri..... 2650
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 29.2.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të paragrafit të dytë të nenit 17, të ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar”..... 2650
	Aneksi nr. 2 i udhëzimit nr. 3, datë 2.2.2016 të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22, datë 15 shkurt 2016, faqe 2197..... 2658



**LIGJ**  
**Nr. 10/2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË LIGJIN NR. 8308, DATË 18.3.1998,  
“PËR TRANSPORTET RRUGORE”,  
TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

<sup>1</sup> Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

Direktivën 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 qershor 2010, “Mbi kuadrin për vendosjen e sistemeve inteligjente në transport në fushën e transportit rrugor dhe për lidhjen me mënyrat e tjera të transportit”, nr. CELEX 321010L0040, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 207, datë 6.8.2010, faqe 1–13.

Direktivën 2006/22/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15 mars 2006, “Mbi kushtet minimale për implementimin e rregulloreve të Këshillit (KEE) nr. 3820/85 dhe (KEE) nr. 3821/85 në lidhje me legjislacionin social në veprimtaritë e transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 88/599/KEE”, Nr. CELEX 32006L0022, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 102, 11.4.2006, faqe 35.

Direktivën 2003/59/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15 korrik 2003, “Mbi kualifikimin fillestar dhe trajnimin periodik të drejtuesve të disa mjeteve rrugore për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, që amendon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3820/85 dhe Direktivën e Këshillit 91/439/KEE dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 76/914/KEE”, nr. CELEX 32003L0059, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 226, 10.9.2003, faqe 4-17.

Rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE”, nr. CELEX 32009R1071, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian L 300, 14.11.2009, faqe 51-71.

Rregulloren (KE) nr.1072/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për hyrjen në tregun ndërkombëtar të transportuesve rrugore të mallrave”, Nr. CELEX 32009R1072, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 300, datë 14.11.2009, faqe 72.

**Neni 1**

1. Kudo në ligj, fjalët “komunë”, “ose komunal”, “ose i komunës”, “ose kryetar i komunës” dhe “këshilli i komunës” shfuqizohen.

2. Kudo në ligj, fjalët “njësi të qeverisjes vendore” zëvendësohen me fjalët “njësi të vetëqeverisjes vendore”.

**Neni 2**

Në nenin 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3.25 ndryshohet si më poshtë:

“3.25. “Kabotazhi” nënkupton transportin rrugor të brendshëm për të tretë ose kundrejt pagesës, i kryer përkohësisht nga një transportues jorezident, i vendosur në një shtet tjetër, anëtar ose jo i BE-së.”.

2. Pas pikës 3.25 shtohet pikat 3.26 me këtë përmbajtje:

“3.26. “Regjistri Elektronik Kombëtar” nënkupton regjistrin, i cili përmban të dhënat e ndërmarrjeve të transportit rrugor në Shqipëri.”.

3. Pas pikës 3.26 shtohet pika 3.27 me këtë përmbajtje:

“3.27. “Sistemet Inteligjente në Transport” ose “SIT” nënkupton sistemet, në të cilat teknologjitë e informacionit dhe komunikimit zbatohen në fushën e transportit rrugor, që përfshin infrastrukturën, mjetet dhe përdoruesit, dhe në menaxhimin e trafikut dhe të lëvizshmërisë, si dhe për lidhjen me metodat e tjera të transportit.”.

**Neni 3**

Neni 6 riformulohet si më poshtë:

**“Neni 6**

Këshilli i Ministrave me vendim përcakton rregulla të hollësishme, për:

a) pranimin e ndërmarrjeve në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor për të tretë ose me qira, për mallra ose udhëtarë, mbështetur mbi këto kërkesa:

- i) reputacionin e mirë;
- ii) qëndrueshmërinë e duhur financiare;
- iii) kompetencën profesionale;
- iv) vendosjen efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri;

b) njohjen e dokumenteve të lëshuara ose të njohura nga shtetet anëtare të BE-së për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor.”.



## Neni 4

Në nenin 10, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) Tarifat e biletave të transportit rrethqytetës të udhëtarëve miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Për rrjetin e linjave rrethqytetëse, sipas shkronjës “ç”, të nenit 15, tarifat përcaktohen me marrëveshje ndërmjet bashkive.”.

## Neni 5

Në nenin 14, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfashtim nga përcaktimet e nenit 13 dhe shkronjës “a”, të paragrafit të parë, të nenit 15, bën vetëm Bashkia e Tiranës, e cila, me vendim të këshillit bashkiak, mund të shtrijë rrjetin e linjave qytetëse në çdo njësi administrative përbërëse, në kufi me njësitë administrative të qytetit të Tiranës, nëse këto njësi përfaqësojnë qendra të zhvilluara e të rëndësishme urbane dhe/ose industriale.”.

## Neni 6

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

## “Neni 15

1. Transporti i udhëtarëve në linja rrethqytetëse është shërbim i rregullt transporti, i cili plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:

a) njësisë administrative përbërëse dhe qendrës së bashkisë së cilës i përkasin;

b) njësisë administrative përbërëse të së njëjtës bashki;

c) fshatrave me njëri-tjetrin ose fshatrave në drejtim të qendrës së njësisë administrative së cilës i përkasin dhe/ose një njësie administrative tjetër të së njëjtës bashki;

ç) fshatrave dhe njësisë administrative përbërëse, të bashkive të ndryshme, por që ndodhen në kufi me njëra-tjetrën.

2. Ky lloj transporti kryhet nga persona juridikë ose fizikë, të pajisur me licencë. Licenca për transportin rrethqytetës jepet nga kryetari i bashkisë ku ka selinë subjekti transportues.”.

## Neni 7

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

## “Neni 16

Transporti ndërqytetës i udhëtarëve me autobus, si transport i rregullt, kryhet në linjat kryesore dhe linjat ushqyese, të parashikuara në rrjetin e linjave të miratuara nga ministri.

Linjat kryesore shërbejnë për të plotësuar nevojat e lëvizjes së popullsisë që lidhin bashkitë, si më poshtë:

a) bashkitë qendër të qarqeve të ndryshme;

b) një bashki qendër qarku me bashkitë jo qendër qarku të një qarku tjetër ose dy bashki jo qendër qarku të qarqeve të ndryshme.

Transporti në linjat kryesore kryhet pa ndalime ose me ndalime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës.

Linjat ushqyese lidhin dy bashki brenda një qarku, me qëndrime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës, të përcaktuara në rrjetin e linjave.

Transporti ndërqytetës kryhet nga persona juridikë, të organizuar në shoqëri transporti e të pajisur me licencë.”.

## Neni 8

Në nenin 17, paragrafi i tretë shfuqizohet.

## Neni 9

Në nenin 18, pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Autobusët, që përdoren në shërbimet e rregullta të transportit të udhëtarëve, janë të pajisur me pajisje regjistrimi (tahograf), në përputhje me aktet në fuqi.

Koha e punës dhe e pushimit të drejtuesve të mjetit rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

Drejtuesit e autobusëve dhe drejtuesit e autoveturave me 8+1 vende, kur e parashikojnë dispozitat e këtij ligji, pajisen me certifikatën e aftësisë profesionale, në përputhje me udhëzimin e ministrit.”.

## Neni 10

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

## “Neni 19

Rrjeti i linjave ndërqytetëse (kryesore dhe ushqyese), stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve për secilën linjë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin çdo tre vjet.



Rrjeti i linjave rrethqytetëse, stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 15, miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ndërsa për shkronjën “ç” miratohen nga këshilli i qarkut.

Rrjeti i linjave rrethqytetëse miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të cenohet rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose i qarkut, respektivisht, miraton linjat në rrjetin e linjave rrethqytetëse, në të cilat lejohet përdorimi i autoveturave me 8+1 vende.

Hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse dhe ndërqytetëse bazohet mbi të dhënat demografike e gjeografike, gjendjen social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukturës rrugore.

Hartimi i rrjetit të linjave ndërqytetëse mbështetet në nevojat e lëvizjes së udhëtarëve për në ose nga bashkitë qendër qarku, bashkitë e tjera dhe destinacionet dimërore apo verore dhe qendrat historike.

Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore me qendrat e njësive administrative përbërëse dhe qendrat e njësive administrative përbërëse me fshatrat dhe fshatrat ndërmjet tyre.”

Neni 11

Neni 20 shfuqizohet.

Neni 12

Pas nenit 21 shtohen nenet 21/1 dhe 21/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Terminali i autobusëve është infrastruktura e transportit që plotëson kushtet e nevojshme për mbërritjen dhe nisjen e autobusëve, hipjen ose zbritjen e udhëtarëve e të bagazheve të tyre dhe për shërbime të tjera, që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorëve të transportit rrugor. Vendndodhja e terminalit të autobusëve caktohet me vendim të këshillit bashkiak.

Kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, kategorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Operatorët e terminaleve të autobusëve mund të jenë subjekte publike ose private, të pajisura me autorizim nga kryetari i bashkisë, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Terminali i autobusëve u ofron shërbime në kushte të barabarta të gjithë operatorëve të transportit, që janë të pajisur me licencë për transport udhëtarësh, bazuar në kategorinë e terminalit të autobusëve, sipas tarifave të përcaktuara me udhëzim nga ministria, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat.

Neni 21/2

Çdo udhëtar pajiset me biletë për udhëtimin e përshkruar. Biletat blihen në terminalin e autobusëve, në autobus, në agjenci ose në çdo vend tjetër, të cilit operatori i transportit i ka dhënë të drejtën për shitje.

Udhëtari në autobus paraqet biletën e udhëtimit, me kërkesë të personit të autorizuar nga operatori i transportit ose të organeve të kontrollit në rrugë.

Modeli i biletave të udhëtimit përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin. Biletat mund të jenë me faturë ose elektronike, por, në çdo rast, përmbajnë të paktën:

- a) gjatësinë e udhëtimit në km;
- b) çmimin për km;
- c) numrin e serisë;
- ç) emrin e operatorit të transportit;
- d) datën dhe kohën e nisjes;
- dh) pjesën e biletës (dëshminë/etiketën) për bagazhin e udhëtarit.

Me propozim të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit përgjegjës për financat, Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për prodhimin dhe shpërndarjen e biletave.”

Neni 13

Në nenin 22, paragrafi i dytë riformulohet si më poshtë:

“Nuk mund të organizohet transporti me autobusë, si pikënisje nga një qendër e banuar, bashki ose qendër e njësisë administrative përbërëse, në qoftë se aty nuk është organizuar njëkohësisht shërbimi i rregullt me agjenci.”

Neni 14

Pas nenit 39 shtohet neni 39/1 me këtë përmbajtje:



## “Neni 39/1

Drejtuesit e mjeteve me peshë të përgjithshme të lejuar me ngarkesë mbi 6 tonë ose kur ngarkesa e lejuar, përfshirë rimorkion ose gjysmërimorkion, i kalon 3,5 tonë në transportin e mallrave, pajisen me certifikatën e aftësisë profesionale, në përputhje me udhëzimin e ministrit.”.

## Neni 15

Në nenin 52/1, pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Rregullat dhe kushtet për kryerjen e operacioneve të kabotazhit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe, të cilat e parashikojnë atë.”.

## Neni 16

Në nenin 68 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “ç” riformulohet si më poshtë:

“ç) 52/1, shkëlja e rregullave të kabotazhit në transportin e mallrave dënohet sipas rastit:

- i) me gjobë nga 100 000 deri në 200 000 lekë;
- ii) me heqjen e lejes përkatëse, kur operacionet e kabotazhit parashikohen të kryhen me leje;
- iii) me refuzimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

2. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) 18, me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë.”.

## Neni 17

Pas nenit 77 shtohen nenet 77/1 dhe 77/2 me këtë përmbajtje:

## “Neni 77/1

Të gjitha ndërmarrjet e transportit rrugor të vendosura në Shqipëri janë të detyruara të regjistrohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor, që mbahet nga organi i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të dhënat përkatëse, të përfshira në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor, do të jenë të aksesueshme për të gjitha autoritetet kompetente, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.

Pas licencimit të subjektit transportues, organi që e ka licencuar atë dërgon informacion te

mbajtësi i Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor për ndërmarrjen e transportit dhe çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Për mbledhjen, përpunimin, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor zbatohen dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rregulla të hollësishme për kategoritë e të dhënave që mbahen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor, si dhe mënyra e mbajtjes së tij përcaktohen me udhëzim të ministrit, në përputhje me detyrimet e legjislationit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

## Neni 77/2

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, pjesë përbërëse e sistemeve inteligjente në transport, zbatohen në fushën e transportit rrugor, duke përfshirë infrastrukturën, mjetet e përdoruesit dhe menaxhimin e trafikut dhe të lëvizshmërisë.

Aplikimet dhe shërbimet e sistemeve inteligjente në transport (SIT) në fushën e transportit rrugor, si dhe lidhjet me metodat e tjera të transportit zbatohen pa cenuar çështjet që lidhen me sigurinë kombëtare dhe interesat e mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

Rregullat për zbatimin e sistemeve inteligjente në fushën e transportit rrugor dhe lidhjet me mënyrat e tjera të transportit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Ky nen zbatohet në përputhje me detyrimet e ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.”.

## Neni 18

1. Ministri përgjegjës për transportin miraton rregullat e ri të linjave ndërqytetëse, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Licencat për transportin ndërqytetës, të lëshuara nga bashkitë, dhe licencat e transportit rrethqytetës, të lëshuara nga bashkitë ose komunat, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në ditën e lëshimit të licencave, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por jo më vonë se data 1 janar 2017.

3. Këshilli i Ministrave dhe ministritë e ngarkuara për zbatimin e këtij ligji të marrin masat për nxjerrjen e vendimeve e të udhëzimeve



përkatëse brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 19  
**Aktet nënligjore**

Këshilli i Ministrave dhe ministritë e ngarkuara për zbatimin e këtij ligji të marrin masat për nxjerrjen e vendimeve e të udhëzimeve përkatëse brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 20

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Nenet 77/1 dhe 77/2 hyjnë në fuqi në datën 1 janar 2017.

Miratuar në datën 11.2.2016.

**Shpallur me dekretin nr. 9453, datë 1.3.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani**

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 4.2.2016**

**PËR PËRCAKTIMIN E BUXHETIT E TË DREJTIMEVE PRIORITARE TË FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE DHE KALENDARIT TË PROGRAMEVE TË FINANÇIMIT, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

**VENDOSI:**

1. Buxheti i shtyllës I - Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, në vlerën 9 000 000 000 (nëntë miliardë) lekë, detajohet si më poshtë vijon:

a) 65% e këtij buxheti programohet për shlyerjen e detyrimeve për projektet në vazhdim;

b) 35% e këtij buxheti programohet për financimin e projekteve të reja, për grantet e mëposhtme:

i) Granti për “Infrastrukturën vendore dhe rajonale”, pjesë e shtyllës I, të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve;

ii) Granti për “Mbështetje për ekonominë”, pjesë e shtyllës II, të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve dhe masa të tjera;

iii) Granti për “Shqipërinë dixhitale”, pjesë e shtyllës III, të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. Fondet e përfuara nga vlera e kursyer, pas lidhjes së kontratës, për projektet me cikël financimi 2015–2016, shpërndahen në thirrjen e radhës, për financimin e projekteve, sipas specifikës së thirrjes.

3. Miratimin e drejtimit prioritar dhe të peshës specifike referuese për secilin prioritet të zhvillimit, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kalendarit i thirrjeve për financim, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, për 6-mujorin e parë të vitit 2016, është sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohen sekretariatet teknike në ministritë përkatëse të linjës dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Tabela 1. Drejtimet prioritare, shtylla, programi e granti i financimit dhe masat për secilin prioritet të zhvillimit

Nr.	Drejtimet prioritare	Shtylla/programi/granti	Masat	Pesha specifike referuese
1.	Rivitalizimi i qytetit, fshatit, poliçendrave urbane dhe ekonomive lokale	Shtylla I - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale", - granti 1: "Infrastruktura vendore dhe rajonale"	Rivitalizimi i hapësirave publike, hapësirave me tipare natyrore, zonave dhe infrastrukturës në shërbim të ekonomive lokale	33%
			Rivitalizimi i poliçendrave urbane dhe qendrave lokale	
			Përmirësimi i aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës	
			Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve	
2.	Kohezioni territorial dhe zhvillimi rajonal	Shtylla I - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale", - granti 1: "Infrastruktura vendore dhe rajonale"	Përmirësimi i infrastrukturës dhe promovimi i atraksioneve (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi)	7%
			Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës ndërlidhëse ndërvendore, rajonale dhe ndërrajonale	
			Pasurimi dhe gjallërimi i parqeve urbane, ndërvendore	
			Ngritja e qendrave multifunkionale (edukim-luaj-sport)	
3.	Stimulimi i zonave dhe poleve potenciale, cluster të zhvillimit	Shtylla I - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale", - granti 1: "Infrastruktura vendore dhe rajonale"	Promovimi i ngritjes së itinerareve kulturore/turistike (infrastrukturë aksesit etj.)	40%
			Stimulimi i investimeve në grupime zonash me interes turistik, bujqësor etj.	
			Promovimi dhe fuqizimi i zonave me potencial ekonomik (investime për krijimin e vlerës së shtuar)	
4.	Qytetet moderne	Shtylla III - Programi "Shqipëria dixhitale". - Granti 1. "Shqipëria dixhitale"	Platforma inovative me të dhënat e qyteteve në shërbim të qytetarëve	7%
			Sisteme dixhitale multifunkionale për menaxhimin e infrastrukturës së qyteteve në shërbim të qytetarëve	
			Shërbime vendore dixhitale për qytetarët dhe biznesin bazuar në zgjidhjet "Në një sportel" nëpërmjet platformave të integruara	
5.	Mbështetje për Ekonominë	Shtylla II - "Programi i mbështetjes për ekonominë", - granti 1: "Mbështetje për ekonominë" dhe masa të tjera	Për t'u zhvilluar sipas pikës 2.2, të aneksit 3, të ligjit të buxhetit për vitin 2016	13%
<b>TOTALI</b>				<b>100%</b>



Tabela 2. Kalendar i thirrjeve për financim, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit për 6-mujorin e parë të vitit 2016

Thirrja	Data	Shtylla/programi/granti	Projekte	Vlera e grantit për thirrje
Thirrja I	4 shkurt 2016	Shtylla 1 - Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale - Granti 1: Infrastruktura vendore dhe rajonale	Projekte që shërbejnë si katalizator i rivitalizimit të qytetit, përmes jetëzimit të hapësirave publike e të ekonomive lokale, përmirësimit të aksesit e të lëvizshmërisë, rivitalizimit të poliçendrave urbane dhe të përmirësimit të infrastrukturës vendore	2,500,000,000
			Projekte të zhvillimit rajonal, të fokusuara në përmirësimin e infrastrukturës së ndërveprimit ekonomik, që adresojnë një nevojë të zhvillimit social-ekonomik rajonal, përmirësojnë aksesin rajonal, ndër-rajonal dhe rivitalizimin e qendrave rajonale	500,000,000
Thirrja 2	29 shkurt - 9 mars 2016	Shtylla 1 - Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale - Granti 2. Arsimi	Përmirësimi i cilësisë së arsimit bazë, të mesëm dhe të lartë	900,000,000
		Shtylla 1 - Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale - Granti 3. Shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor)	Përmirësimi i shërbimeve për kujdesin shëndetësor parësor	19,000,000
		Shtylla 1 - Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale - Granti 6: Rehabilitimi mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzimin	Rehabilitimi mjedisor i zonave të degraduara, gjelbërimi i hapësirave publike dhe rivitalizimi i parqeve urbane	90,000,000
		Shtylla 3 - Programi "Shqipëria dixhitale". - Granti 1. "Shqipëria dixhitale"	Qytetet moderne - Përmirësimi dhe modernizimi i shërbimeve publike vendore	500,000,000
Thirrja 3	Java III e marsit – java I e prillit	Shtylla 1 - Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale - Granti 1: Infrastruktura vendore dhe rajonale	Stimulimi i zonave dhe poleve potenciale, cluster të zhvillimit	3,100,000,000

**VENDIM**  
**Nr. 8, datë 4.2.2016**

**PËR DETYRAT DHE FUNKSIONIMIN E**  
**SEKRETARIATEVE TEKNIKE PËR**  
**ADMINISTRIMIN E FONDIT PËR**  
**ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Sekretariatet teknike në ministrinë përkatëse të linjës ngrihen me akt të posaçëm të ministrit përgjegjës, sipas programeve të financimit nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, specifikuar si më poshtë vijon:

a) Shtylla 1: Programet e zhvillimit vendor dhe rajonal:

- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban;

- Sekretariati teknik për grantet konkurruese për arsimin, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për shëndetësinë, pranë Ministrisë së Shëndetësisë;

- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për artin dhe kulturën, pranë Ministrisë së Kulturës;

- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për ujësjellës-kanalizimet, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës;

- Sekretariati teknik për grantin konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzimin, pranë Ministrisë së Mjedisit.





b) Shtylla 2: Programi “Mbështetje për ekonominë”, sekretariati teknik për grantin konkurrues për programin “Mbështetje për ekonominë”, pranë Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal.

c) Shtylla 3: Programi “Shqipëria dixhitale” (inovacioni dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit), sekretariati teknik për grantin konkurrues për programin “Shqipëria dixhitale”, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

2. Përbërja e sekretariateve teknike duhet të sigurojë/të garantojë vendimmarrje politikëbërëse, planifikim dhe programim nevojash për financim, sipas specifikës së programit, vlerësim teknik e financiar të projekteve, si dhe asistencë në mirëmbajtjen e përditësimin e bazës elektronike të informacionit.

3. Sekretariatet teknike ngarkohen:

- të administrojnë aplikimet, të kryejnë procesin e vlerësimit teknik (sipas kriterëve të përcaktuara në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve), të përputhshmërisë financiare e ligjore me ligjin e buxhetit, aneksin 3 dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, si dhe të përputhshmërisë me programet e nënprogramet zhvillimore e të impaktit të aplikimeve për financim dhe raportimin pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së mbledhjes së Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

- të bëjnë njoftimin zyrtar tek autoritetet kontraktuese për miratimin e financimit, monitorimin e statusit e të ecurisë së zbatimit të projekteve dhe raportimin pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij vendimi;

- të bëjnë vlerësimin e ecurisë financiare të përdorimit të fondit (mosrealizimit të fondit) e të zbatimit, realizimit të investimeve e të impaktit të projekteve të financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe raportimin pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në mënyrë periodike, sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij vendimi;

- të bëjnë raportimin vjetor për performancën e financimit e të zbatimit të programeve dhe nënprogrameve pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, jo më vonë se data 15 dhjetor e vitit kalendar, sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi;

- të bëjnë analizën vjetore, të programojnë dhe të propozojnë pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve politikën dhe drejtimet prioritare të vitit të ardhshëm dhe të dërgojnë propozimet për programet e nënprogramet e zhvillimit pranë Sekretariatit të Përgjithshëm.

4. Rregullat e organizimit të punës hartohen të detajuara dhe miratohen nga ministri përgjegjës për menaxhimin e programeve e të nënprogrameve, respektive.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Kulturës, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Mjedisit, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 4	anëtar.



**Aneksi 1.** Raporti i vlerësimit tekniko-financiar për aplikimet për financim (model reference)  
Ministria e \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

FZHR 2016

SEKRETARIATI TEKNIK

### 1. Përshkrim i përgjithshëm

Në bazë të vendimit nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave “Për \_\_\_\_\_”, Ministria e \_\_\_\_\_, në rolin e sekretariatit teknik, pranoi aplikimet për financim të \_\_\_\_ projekteve nga njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë e zhvillimit, nga data \_\_\_\_ deri në datën \_\_\_\_\_. Projektet konsistojnë konkretisht në fushat:

- -----
- -----
- -----

Për të gjitha projektet aplikuese është kryer vlerësimi në bazë të kriterëve të përcaktuara në vendimin/et të sipërcituar/a, si dhe nënkriteret e përcaktuara nga sekretariati teknik dhe për projektet e vlerësuara në përputhje me këto kërkesa është kryer vlerësimi teknik. Procesi i verifikimit dhe vlerësimit teknik të projekteve është kryer nga Sekretariati Qendror Teknik i Ministrisë së \_\_\_\_ i ngritur me urdhrin nr. ---- datë ---- nga ministri i -----, z.----- ----- . Vlerësimi u krye, i asistuar nga stafi i ministrisë në rolin e sekretariatit teknik.

### 2. Procesi i vlerësimit

Të gjitha projektet janë vlerësuar sipas kriterëve teknike (të përcaktuara në vendimet e KZHR-së) ligjore dhe financiare, në përputhje me ligjin e buxhetit, aneksin 3.

Kriteret e vlerësimit teknik janë si më poshtë:

- Cilësia teknike dhe kostimi, nga 0–25 pikë;
- Nivel i ulët i riskut (zbatim me sukses i projektit dhe përdorim në kohë i fondeve publike), 0–10 pikë;
- Ndikimi i projektit në shërbimet bazë, në cilësinë e jetës, nga 0–5 pikë;
- Bashkëfinancim nga njësitë vendore ose donatorët, nga 0–5 pikë;
- Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga realizimi i projektit, nga 0–10 pikë;
- Analizat dhe studimet e kryera në funksion të projektit që aplikohet, nga 0–5 pikë.
- Qëndrueshmëria e investimit (kosto mirëmbajtjeje për vazhdimësinë etj.), nga 0–5 pikë.

*(mënyra e vendosjes së pikëve për secilin nga kriteret e mësipërme pasqyrohet në tabelën shoqëruese për secilin nga projektet që janë vlerësuar gati për zbatim.)*



### 3. Përgatitja e vlerësimit teknik për secilin projekt

Raporti i vlerësimit përfshin të gjitha të dhënat e marra gjatë procesit të vlerësimit.

Projektet janë kategorizuar në ---- grupe, si më poshtë vijojnë:

- Projekte gati për zbatim, të strukturuar sipas qarqeve, njësive vendore dhe vlerave respektive;
- Projekte që kanë nevojë për përmirësime, të strukturuar sipas qarqeve, njësive vendore dhe vlerave respektive;
- Projekte që nuk janë gati për zbatim (*për të cilat është gjykuar të njoftohen për plotësimin dhe saktësimin e dokumentacionit për të vijuar me trajtimin në fazën pasardhëse*).

Bazuar në problematikën e ndeshur, janë hartuar komentet për secilin projekt në formatin e vlerësimit.

### 4. Gjetje kryesore e rekomandime

Pas verifikimit të projekteve që kanë aplikuar pranë sekretariatit teknik u konstatua një numër i madh aplikimesh që plotësonin kriteret teknike dhe u klasifikuan si projekte gati për zbatim, përkatësisht:

1. -----
2. -----
3. -----
4. -----
5. -----

Referuar kategorizimit të mësipërm, nga ---- projekte të shqyrtuara, rezulton si më poshtë vijon:

Statusi i projekteve	Numri i projekteve
Projekte gati për zbatim	----
Projekte të cilat janë gati për zbatim, por kanë nevojë për përmirësime	----
Projekte të cilat nuk janë gati për zbatim	----

Në përfundim të vlerësimit, konstatohet se janë ----- projekte gati për zbatim, të vlerësuara sipas kriterëve të vlerësimit teknik e financiar.

Raporti i plotë i sekretariatit teknik duhet të ketë bashkëlidhur:

Tabelat e projekteve që janë gati për zbatim, të strukturuar sipas qarqeve, njësive vendore dhe vlerave respektive.

Tabelat e vlerësimit me pikë, sipas kriterëve teknike, për të gjitha projektet të kategorizuara si gati për zbatim.



**Aneksi 2.** Raporti për statusin e projekteve fituese dhe ecurinë e zbatimit të punimeve (model reference)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e \_\_\_\_\_

---

**RAPORT PËR STATUSIN E PROJEKTEVE FITUESE DHE ECURINË E ZBATIMIT  
TË PUNIMEVE**

FZHR 2016

SEKRETARIATI TEKNIK

---

**I. Statusi i projekteve fituese në varësi të aplikimit të procedurave të prokurimit**

- Jepni statusin e projekteve fituese duke paraqitur numrin e projekteve, që:
  - a) nuk kanë nisur procedurat e prokurimit;
  - b) kanë shpallur tenderin;
  - c) janë duke vlerësuar ofertat;
  - ç) kanë shpallur fituesin;
  - d) kanë lidhur kontrata;
  - dh) kanë nisur punimet.
- Paraqitni problematikën e ndeshur gjatë aplikimit të procedurave të prokurimit dhe jepni numrin e projekteve që kanë vonesa në aplikimin e procedurave të prokurimit.
- Verifikoni dhe raportoni nëse ka projekte, të cilat nuk kanë respektuar ose janë të vonuara në aplikimin e procedurave të prokurimit, duke rrezikuar djegien e fondit të akorduar e, si rrjedhojë, mund/duhet t'u anulohet financimi i projektit.
- Sa janë tepricat e fondeve të akorduara, pas lidhjes së kontratave të punimeve dhe bëni propozime për rialokimin e fondeve të tepruara, sipas nevojave të programit.

**II. Ecuria e zbatimit të punimeve, të projekteve fituese**

- Si ka qenë ecuria e projekteve që nga momenti i çeljes së fondeve? Jepni statusin e projektit në %, përshkruani fazën në të cilën ndodhet.
- Cilat janë aktivitetet që pasojnë deri në përmbylljen e projektit. Jepni afatin e parashikuar për përmbylljen e projektit.
- Sa projekte janë përmbyllur dhe sa janë në vazhdim? Jepni edhe vlerën e fondit të nevojshëm për përmbylljen e projekteve në vazhdim, sipas fushave respektive të financimit.
- Verifikoni dhe raportoni nëse ka projekte, të cilat:



- a) kanë performancë të dobët të zbatimit të punimeve dhe për të cilat duhet reduktuar fondi i akorduar për vitin kontraktual;
- b) kanë performancë shumë të mirë të zbatimit të punimeve dhe për të cilat duhet avancuar me fondin e akorduar për vitin kontraktual.

### **III. Vlerësimi i riskut financiar për projektet me ecuri punimesh nga 0–10%**

- Vlerësimi i riskut të realizimit të investimit, të planifikuar për vitin 2015, të bëhet në bazë të 4 (katër) kriterëve të vlerësimit, si më poshtë vijon:
  - a) statusi aktual i projektit (nuk ka nisur procedura në tenderim lidhur kontratën);
  - b) zbatueshmëria/mundësia kohore e projektit;
  - c) mundësia zbatuese/menaxhuese e autoritetit kontraktues (niveli i NJQV-së që menaxhon fondin);
  - d) vlera e planifikuar për investim në vitin 2016.
- Jepni numrin e projekteve sipas klasifikimeve “Risk i lartë”, “Risk mesatar” dhe “Risk i ulët”.

### **IV. Rekomandime dhe sugjerime**

- Propozoni zgjidhje dhe jepni rekomandime për administrimin e riskut dhe të projekteve, sipas klasifikimeve të riskut.



**Aneksi 3.** Raporti vjetor për performancën e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (model reference)

Ministria e \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**RAPORT VJETOR PËR PERFORMANCËN E FZHR-së**  
FZHR 2016  
SEKRETARIATI TEKNIK

Ky raport vlerësues përmbledh ecurinë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Do të përmbajë të dhëna shifrore, tabelore etj., për numrin e projekteve të aplikuara, të shpallura fituese për financim, informacion për projektet në vazhdim të trajtuara me skemën e borxhit. Probleme të identifikuar dhe rekomandime për adresimin e tyre:

**I. Ecuria e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015–2016**

- Sa është fondi i alokuar për vitin 2015–16, i ndarë sipas fushave të investimit. Informacioni të shoqërohet me të dhëna shifrore dhe tabelore.
- Jepni numrin e NJQV-ve që kanë aplikuar, numrin e projekteve të aplikuara dhe numrin e projekteve të shpallura fituese. Informacioni për projektet e financuara duhet të paraqesë dhe orientimin e financimit sipas rajoneve të Shqipërisë.
- Si ka qenë ecuria e projekteve që nga momenti i çeljes së fondeve? Jepni statusin e projektit në %, përshkruani fazën në të cilën ndodhet dhe cilat janë aktivitetet që pasojnë deri në përmbylljen e projektit. Jepni afatin e parashikuar për përmbylljen e projektit.
- Sa projekte janë përmbyllur dhe sa janë në vazhdim? Jepni edhe vlerën e fondit të nevojshëm për përmbylljen e projekteve në vazhdim, sipas fushave respektive të financimit (infrastrukturë vendore, ujësjellës-kanalizime, vaditje-kullim, arsim, pyllëzim, shëndetësi, art-kulturë).
- Vlerësoni se cilat nga NJQV-të rrezikon menaxhimin apo përmbylljen e projektit/investimit, si pasojë e reformës territoriale, ndryshimit të kufijve administrativë.
- Paraqitni problematikën e identifikuar gjatë procesit të FZHR-së në tërësi (shpallja e thirrjes, shpërndarja e fondit, çelja në thesar, prokurimi e tenderimi, komunikimi me NJQV-të etj.). Propozoni zgjidhje dhe jepni rekomandime për adresimin e problematikës së ndeshur.

**II. Planifikimi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve 2016–2017**

- Jepni parashikimet/projeksionin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, sipas parashikimeve buxhetore 2016–17.
- Sa i përmbush ky fond i parashikuar për vitin 2016–17 nevojat e ministrisë për mbylljen e projekteve në vazhdim dhe hapjen e projekteve të reja.

**III. Rekomandime dhe sugjerime**

- Propozoni zgjidhje dhe jepni rekomandime për administrimin dhe koordinimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.



## UDHËZIM

Nr. 5, datë 19.2.2016

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 758,  
DATË 16.9.2015, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE PËR NGARKIMIN E  
MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE  
DHE RINISË PËR KRYERJEN E  
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR  
PAJISJEN ME DEKODERA TË  
FAMILJEVE NË NEVOJË, PËRFITUESE  
NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE,  
DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR  
PËR KËTË MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të nenit 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të nenit 22 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 4 të vendimit nr. 758, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave për ngarkimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për këtë ministri”,

## UDHËZOJ:

1. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë bën transferim kapitali të dekoderve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror të shoqëruar me fletëdalje.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror lidh marrëveshje me bashkitë për shpërndarjen e dekoderve të familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike si përdorues fundorë të këtyre pajisjeve.

3. Çdo bashki dërgon listat e familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike pas njoftimit të marrë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, e cila i dorëzon këto lista pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet strukturave të saj rajonale

transferon pranë çdo bashkie dekoderrat përkatës dhe administron dokumentacionin që vërteton dorëzimin e mallit.

5. Bashkitë realizojnë shpërndarjen e dekoderve të familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe administrojnë dokumentacionin që vërteton dorëzimin e mallit të përdo-ruesi fundor, së bashku me kopjen e kartës së identitetit të nënshkruar nga personi që tërheq dhe merr në dorëzim ndihmën ekonomike.

6. Pajisja me dekodera e familjeve në nevojë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike do të realizohet në mënyrë progresive, sipas zonave të përcaktuara nga Radio Televizioni Shqiptar të dërguara zyrtarisht pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimit Social Shtetëror, për shtrirjen e sinjalit dixhital, i cili do të zëvendësojë atë analog.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE  
DHE RINISË  
Blendi Klosi

## VENDIM

Nr. 10, datë 29.2.2016

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Gani Dizdari	anëtar	i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar	i	“	“
Fatos Lulo	anëtar	i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 29.10.2015, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 60/18 Akti, që i përket:

KËRKUES: Avokati i Popullit

SUBJEKETE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i paragrafit të dytë të nenit 17, të ligjit nr. 183/2014, datë



24.12.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 7, 15, 17, 18, 42, 131, shkronja “a”, dhe 134/1, shkronja “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 8 dhe 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Politike; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

##### I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), në datën 24.12.2014, miratoi ligjin nr. 183/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9870, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar” (*këtu e në vijim ligji nr. 183/2014*). Ndër të tjera, ky ligj ka ndryshuar edhe përmbajtjen e nenit 14 të ligjit bazë, si vijon: “*Kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë, brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit*”.

*Ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore nuk pezullon ekzekutimin e tij.*

*Në rast se, në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati që ka dhënë vendimin dëmspërblimin për dëmin e shkaktuar”.*

2. Ligji nr. 183/2014 është shpallur me dekretin nr. 8900, datë 16.1.2015, të Presidentit të Republikës dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 214, datë 21.1.2015. Sipas nenit 23 të këtij ligji, ku parashikohet hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, rezulton se ka hyrë në fuqi në datën 5.2.2015.

3. Avokati i Popullit, në ushtrim të funksioneve të tij për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e

ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike, ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin si antikushtetuese të dispozitës së sipërcituar.

##### II

4. **Kërkuari** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 17 të ligjit nr. 183/2014, mbështetur në këto argumente:

4.1 *Është cenuar e drejta për jetën familjare*, për shkak se dispozita e kundërshtuar përbën një kufizim të së drejtës për sigurinë e banesës dhe ruajtjen nga dëbimet e detyrueshme, duke shkelur mbrojtjen që garanton neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Heqja e mundësisë së gjykatës për pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, që passjell dëbimin (siç është vendimi për prishjen e banesës), u heq mundësinë individëve të prekur që të kërkojnë nga një gjykatë e paanshme të vlerësohet rast pas rasti nëse janë përpara kufizimit të së drejtës për strehim.

4.2 *Është cenuar parimi i proporcionalitetit*, pasi rregulli i ri ligjor nuk respekton kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës. Prishja e banesës sjell doemos dëbimin e individëve nga banesa përpara prishjes së saj dhe ky është një dëbim i detyrueshëm. Nëse gjykatat nuk kanë mundësinë që të marrin në konsideratë faktin se paditësit rrezikojnë të mbeten të pastrehë dhe për këtë arsye ta konsiderojnë këtë rrezik iminent, të rëndë dhe të riparueshëm, në rastet kur individët mund të jenë në kushtet e pamundësisë financiare për të siguruar banesë alternative, atëherë jemi përpara shkeljes së nenit 8 të KEDNJ-së përmes një ndërhyrjeje joproportionale.

4.3 *Është cenuar parimi i sigurisë juridike*, pasi dispozita e kundërshtuar përkeqëson situatën juridike të shtetasve, të cilët eventualisht preken nga një akt administrativ i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT-ja) ose njësisë vendore. Në rastin konkret ndodhemi përpara një mase regresive, pasi dispozita e re heq një të drejtë të fituar (*pezullimi për shkak të një ankimi administrativ dhe gjyqësor*), duke mos u shoqëruar me asnjë justifikim dhe pa bërë asnjë analizë të burimeve në dispozicion të shtetit.

4.4 *Është shkelur parimi i mosdiskriminimit*, pasi familjet rome/egjiptiane përballen me një kërcënim





veçanërisht akut të dëbimit për shkak të dështimit të vazhdueshëm të autoriteteve shqiptare që në mënyrë adekuate dhe efektive të respektojnë dhe mbrojnë të drejtën e tyre për strehim.

4.5 *Është cenuar e drejta për një ankim efektiv*, pasi dispozita e kundërshtuar pengon në mënyrë reale shqyrtimin gjyqësor, duke sjellë dëme të rënda dhe të pariparueshme. Fakti që ankimi gjyqësor sidoqoftë nuk pengohet, nuk është i mjaftueshëm për të parandaluar e aq më tepër për të dëmshpërblyer një situatë të pakëndshme, siç është ajo e krijuar nga pengesa për të mbrojtur sigurinë e banesës. Edhe pse teorikisht gjykata ka mundësi të marrë masën e pezullimit për sigurimin e padisë, ky instrument procedural mbetet i paefektshëm.

4.6 *Është cenuar parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor*, pasi është mohuar e drejta e pezullimit të aktit administrativ, e cila është një e drejtë që lidhet pazgjidhshmërisht me procesin e rregullt ligjor dhe përbën prerogativë të natyrshme të organeve gjyqësore.

5. **Subjekti i interesuar**, Këshilli i Ministrave (KM-ja), ka prapësuar:

5.1 *Në lidhje me pretendimin për cenimin e jetës familjare dhe parimin e proporcionalitetit*, KM-ja vlerëson se miratimi i këtij ligji është në funksion të mbrojtjes së interesit të gjerë publik duke synuar mbrojtjen e territorit. Për më tepër, ligji nr. 9780/2007 (*i ndryshuar*) parashikon masën e dënimeve administrative dhe afatet e marrjes së tyre, procedurën e ankimit në gjykatë kundër IKMT-së dhe dëmshpërblimin eventuale për dëmin e shkaktuar. Në këto kushte është e paqartë se si mund të cenohet jeta familjare dhe private e subjekteve në bazë të nenit 8 të KEDNJ-së, për sa kohë funksioni i Gjykatës është të analizojë konfliktet konkrete dhe jo ato të mundshme apo hipotetike.

5.2 Në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe mjeteve ankimore efektive, në kuptim të standardeve të elaboruara nga Gjykata lidhur me parimin e sigurisë juridike, KM-ja vlerëson se ndryshimet në ligjin nr. 9780/2007 (*i ndryshuar*) janë imponuar nga situata shqetësuese e ndërtimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përveç të tjerash, ligjvënësi, duke sanksionuar se ankimi gjyqësor kundër vendimit të IKMT-së dhe atij të njësisë vendore nuk pezullon ekzekutimin e tij, nuk do të thotë se individi nuk ka mundësi apo

aftësi të mbrohet ndaj cenimit eventuale të të drejtave të tij. Për më tepër, legjislacioni në fuqi ofron mjetet e duhura të ankimit për individin dhe ky i fundit gëzon të drejtën e zhdëmtimit për dëmin e shkaktuar dhe rivënien në vend të së drejtës përkatëse.

6. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë megjithëse është njoftuar për gjykimin e çështjes, nuk ka paraqitur parashtrime përpara Gjykatës.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësit

7. Gjykata e ka vlerësuar çështjen e legjitimitimit të kërkuësit (*locus standi*) si një nga aspektet kryesore që lidhen me inicimin e gjykimit kushtetues të normës (kontrolli abstrakt). Kushtetuta në nenin 134/1, shkronja “dh” parashikon si subjekt që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe Avokatin e Popullit. Megjithatë, kjo e drejtë është e kushtëzuar, ajo mund të ushtrohet vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Pra vetëm nëse e përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 134 të Kushtetutës për të argumentuar “interesin e tyre” në një “çështje të veçantë”, subjektet e listuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “p”, të nenit 134/1 legjitimohen *ratione materiae* për t’iu drejtuar Gjykatës në lidhje me kompetencën e saj për të vendosur në këtë rast mbi pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 25.7.2008*).

8. Në lidhje me legjitimitimin e Avokatit të Popullit, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se neni 134/1, shkronja “dh” i Kushtetutës e ka vendosur Avokatin e Popullit në rrethin e subjekteve që mund të iniciojnë një gjykim kushtetues abstrakt të normës, por sipas pikës 2 të po këtij neni, kjo e drejtë kufizohet vetëm për çështjet që lidhen me interesat e këtij subjekti. Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Pra, edhe interesi i tij për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur, si rrjedhojë e zbatimit të ligjit ose aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të



individëve apo edhe kur shkelja e të drejtave, lirive dhe interesave të individit vjen si rezultat i vetë përmbajtjes së këtyre ligjeve apo akteve, d.m.th. kur ato janë në kundërshtim me Kushtetutën. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij. Në këtë rast ai ka të drejtë t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënese të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve apo të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e akteve të tilla (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata ka theksuar se kompetenca e Avokatit të Popullit për t'iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike dhe se është në diskrecionin e tij të zgjedhë mjetet e nevojshme për mbrojtjen e individëve nëse një normë është *prima facie* antikushtetuese (*shih vendimet nr. 27, datë 26.5.2010; nr. 20, datë 4.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se interesi i Avokatit të Popullit për ta vënë atë në lëvizje, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, shqyrtohet rast pas rasti. Në rastin konkret, Gjykata çmon se kërkuesi ka interes në çështjen konkrete, pasi i plotëson kriteret e përcaktuara në standardet e mësipërme, për rrjedhojë legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues, duke karakterizuar kështu ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet pretendimeve të ngritura përpara Gjykatës dhe funksioneve të tij të parashikuara nga Kushtetuta.

11. Referuar standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* përderisa ai është në zbatim të funksioneve të tij të parashikuara nga Kushtetuta. Gjithashtu, ai legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi referuar datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore objekt kërkesë, kërkuesi është brenda afatit trevjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

#### B. Për themelën e pretendimeve

12. Gjykata paraprakisht vëren se pretendimet e ngritura nga kërkuesi lidhen me cenimin e së drejtës për jetën familjare, parimit të proporcionalitetit, sigurisë juridike, mosdiskriminimit dhe

ndarjen e balancimit e pushteteve, si dhe të drejtën për një ankim efektiv. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson t'i analizojë këto pretendime në kuptim të parimit të mosdiskriminimit, sigurisë juridike dhe së drejtës për një ankim efektiv.

#### i) Për cenimin e parimit të mosdiskriminimit

13. Kërkuesi pretendon se mungesa e një mjetei juridik që të sigurojë pezullimin e një vendimi dëbimi, me qëllim parandalimin e shkeljes së nenit 8 të Konventës, është në vetvete një shkelje e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi familjet rome/egjiptiane përballen me një kërcënim, veçanërisht akut të dëbimit për shkak të dështimit të vazhdueshëm të përpjekjeve të autoriteteve shqiptare për respektimin dhe mbrojtjen e së drejtës së tyre për strehim.

14. Në lidhje me mosdiskriminimin Gjykata ka përcaktuar disa standarde, me anë të të cilave ka synuar të vlerësojë nëse një ligj është diskriminues në termat e nenit 18 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007; nr. 19, datë 9.7.2009; nr. 4, datë 12.2.2010; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të mosdiskriminimit i referohen një kategorie të caktuar individësh, konkretisht atyre që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Megjithatë, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë në nivel kushtetues se përmbajtja e dispozitës ligjore të kundërshtuar ka shkaktuar, në mungesë të një përligjijeje të arsyeshme dhe objektive, një pabarazi ligjore ndërmjet subjekteve që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian dhe subjekteve të tjera të cilave u drejtohet dispozita. Ligji nr. 9780/2007 ka për qëllim që të sigurojë respektimin e normave, standardeve dhe legjislacionit në fushën e



ndërtimit, urbanistikës dhe rezervave ujore në të gjithë territorin e vendit, në mënyrë të decentralizuar dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative (neni 1) dhe objekt i tij është përcaktimi i organeve për inspektimin ndërtimor e urbanistik, i organizimit, i rregullave të funksionimit dhe i përgjegjësisë të tyre (neni 2). Në këtë kuptim, ky ligj gjen zbatim në të gjithë territorin dhe zbatohet ndaj të gjithë shtetasve që janë subjekt i tij.

16. Për më tepër, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se ka pasur një cenim real dhe jo potencial të shkaktuar. Kërkuesi parashtrohet në kërkesë se është vënë në lëvizje nga shtetas të ndryshëm, duke përmendur edhe emrat e tyre, por nuk ka sjellë asnjë fakt që të provojë se në ç'mënyrë janë cenuar këto subjekte dhe që ky cenim ka ardhur nga përmbajtja e dispozitës konkrete të kundërshtuar.

17. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e parimit të mosdiskriminimit është i pabazuar dhe si i tillë nuk duhet pranuar.

*ii) Për cenimin e parimit të sigurisë juridike*

18. Kërkuesi pretendon se dispozita e re përkeqëson situatën juridike të shtetasve, të cilët mund të preken nga një akt administrativ i IKMT-së ose njësisë vendore, pasi heq një të drejtë të fituar, që sipas tij është pezullimi për shkak të ankimit.

19. Gjykata rithekson se duke qenë se një ndër elementet më thelbësore të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, del se rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëritë ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpiten në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet

parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës” (*shih vendimin nr. 9/2007 të Gjykatës së Kushtetuesë*). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, ndalimin e ligjeve me fuqi prapavepruese, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike, respektimin e pritshmërive legjitime etj., ndaj dhe analiza e detajuar e këtij parimi nuk mund të realizohet veçse duke analizuar secilin prej këtyre elementeve.

20. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se përmbajtja e ndryshuar disa herë e nenit 14, i cili parashikon çështjen e pezullimit të ekzekutimit të aktit, nuk lidhet me një vendim përfundimtar dhe, për rrjedhojë, nuk mund të analizohet në kuptimin e parimit të sigurisë juridike.

*iii) Për pretendimin për cenimin e së drejtës për një ankim efektiv*

21. Sipas kërkuesit është cenuar e drejta për një ankim efektiv, pasi dispozita e kundërshtuar pengon në mënyrë reale shqyrtimin gjyqësor, duke sjellë dëme të rënda dhe të riparueshme. Sipas tij, mosparashikimi i pezullimit si një prerogativë e natyrshme e organeve gjyqësore në ushtrimin e pushtetit të tyre sjell cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe mosrealizimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

22. Gjykata e vlerëson këtë pretendim në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimin nr. 10, datë 4.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata konstaton se neni 14 i ligjit objekt shqyrtimi parashikon të drejtën e ankimit gjyqësor



ndaj vendimeve të IKMT-së, duke përcaktuar dhe një afat të posaçëm 10-ditor për ushtrimin e ankimit. Në këtë kuptim, parashikimi në ligj i mjetit dhe afatit të ankimit është në përputhje me standardin kushtetues të së drejtës së ankimit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se përderisa në rastin konkret ligji parashikon të drejtën e ankimit gjyqësor, ky parashikim është i mjaftueshëm për të realizuar të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj akteve administrative që nxjerr IMKT-ja.

24. Për më tepër, Gjykata në jurisprudencën e saj ka konstatuar se kontrolli gjyqësor ndaj akteve me karakter administrativ, duke qenë shprehje e parimit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve e duke qëndruar në themel të pavarësisë së organeve, ka ndryshime thelbësore nga kontrolli administrativ që kryhet në rrugë hierarkike apo nga organe të krijuara posaçërisht. Dallimet qëndrojnë, krahas të tjerave, në rrafshin procedural, në kuptim që gjykatat në kontrollin e këtyre akteve respektojnë rregullat e parashikuara në legjislacionin procedural dhe nuk mund të interferojnë e as të adaptojnë procedura administrative. Ndër rregullat procedurale, rëndësi paraqet pezullimi i aktit objekt shqyrtimi nga gjykatat si një mundësi procedurale për të mënjanuar krijimin e pasojave negative nga një akt i kontestuar për kundërligjshmëri. Pezullimi i aktit administrativ si një veprim procedural gjyqësor kushtëzohet nga një sërë elementesh që e bëjnë atë të dallueshëm nga pezullimi si pasojë e ankimit administrativ (*shih vendimin nr. 32, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Në mënyrë të përmbledhur, këto elemente janë: ngritja e padisë për shfuqizimin e aktit administrativ; akti administrativ duhet të jetë objekt shqyrtimi në referim të neneve 28–31, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në padi të jetë kërkuar shprehimisht pezullimi i zbatimit të aktit; të ekzistojnë argumente bindëse për gjykatën se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin; vendimi gjyqësor për pezullim duhet të arsyetohet.

25. Referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se në nenin 14, të ligjit nr. 9870, datë 16.7.2007, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, parashikohet se “ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të

njësisë vendore nuk pezullon ekzekutimin e tij”. Kjo do të thotë se vetëm paraqitja e ankimit në gjykatë për këto vendime nuk shkakton automatikisht pezullimin e tyre. Por, kur pala e interesuar kërkon njëkohësisht edhe pezullimin e këtyre akteve, atëherë gjykata nuk ka asnjë pengesë që kur janë kushtet e nenit 29, të ligjit nr. 49/2012, të vendosë pezullimin e aktit të nxjerrë nga këto organe. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se përmbajtja e nenit 14 nuk e cenon kontrollin administrativ të gjykatës mbi veprimtarinë administrative, për rrjedhojë pretendimi për cenimin e së drejtës për ankim efektiv duhet rrëzuar si i pabazuar.

26. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues cenimin e të drejtave dhe lirive të individit si efekt real dhe i drejtpërdrejtë i dispozitës objekt shqyrtimi. Për rrjedhojë, pretendimet lidhur me karakterin antikushtetues të normës janë të pabazuara e për këtë arsye kërkesa duhet rrëzuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “F”, dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtar kundër: Vladimir Kristo

#### MENDIM PAKICE

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka rrëzuar kërkesën e Avokatit të Popullit për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të paragrafit të dytë të nenit 17, të ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780,



datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar”.

2. Neni 14 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, në formulimin e tij fillestar parashikonte, ndër të tjera, se ankimi administrativ dhe gjyqësor kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, si dhe ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Urbanistik Kombëtar nuk pezullonte ekzekutimin e tij.

3. Me ligjin nr. 23, datë 14.2.2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit””, përmbajtja e nenit 14 parashikonte të drejtën e ankimit duke iu referuar ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, i cili në nenin 51 parashikonte se e drejta e ankimit administrativ pezullonte ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar (por nuk cenonte ekzekutimin e masave urgjente të marra sipas nenit 43 të tij).

4. Sikurse konstaton edhe shumica, neni 17 i ligjit nr. 183, datë 24.12.2014, ka ndryshuar, ndër të tjera, nenin 14 të ligjit nr. 9870, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar si më poshtë:

*“Kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit.*

*Ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore nuk pezullon ekzekutimin e tij.*

*Në rast se në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati që ka dhënë vendimin dëmspërblimin për dëmin e shkaktuar”.*

5. Avokati i Popullit ka pretenduar se paragrafi i dytë i nenit 17 të ligjit nr. 183, datë 24.12.2014 (neni 14 i ligjit bazë) cenon disa parime kushtetuese, që lidhen me të drejtën për jetën familjare, proporcionalitetin, sigurinë juridike, mosdiskriminimin dhe ndarjes e balancimit të pushteteve, si dhe të drejtën për një ankim efektiv.

6. Shumica në vendimin e saj ka arsyetuar se nuk cenohet parimi i mosdiskriminimit, pasi në kuptim të neneve 1 dhe 2 të ligjit objekt shqyrtimi, ai nuk i referohet një kategorie të caktuar individësh, konkretisht atyre që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, por gjen zbatim në të gjithë territorin dhe zbatohet ndaj të gjithë

shtetasve që janë subjekt i tij (*shih paragrafin nr. 15 të vendimit të shumicës*). Lidhur me parimin e sigurisë juridike, shumica ka vlerësuar se përmbajtja e ndryshuar disa herë e nenit 14, i cili parashikon çështjen e pezullimit të ekzekutimit të aktit, nuk lidhet me një vendim përfundimtar dhe, për rrjedhojë, nuk mund të analizohet në kuptimin e parimit të sigurisë juridike (*shih paragrafin nr. 20 të vendimit të shumicës*). Ndërsa për sa i përket cenimit të së drejtës së ankimit të pretenduar nga Avokati i Popullit, shumica është shprehur se pavarësisht se neni 14 i ligjit në fjalë parashikon se vetëm paraqitja e ankimit në gjykatë për këto vendime nuk shkakton automatikisht pezullimin e tyre, kur pala e interesuar kërkon njëkohësisht edhe pezullimin e këtyre akteve, atëherë gjykata nuk ka asnjë pengesë që kur janë kushtet e nenit 29, të ligjit nr. 49/2012, të vendosë pezullimin e aktit të nxjerrë nga këto organe. Prandaj, sipas shumicës, përmbajtja e nenit 14, nuk e cenon kontrollin administrativ të gjykatës mbi veprimtarinë administrative (*shih paragrafin nr. 25 të vendimit të shumicës*).

7. Arsyetimin e shumicës e gjej të sforcuar, të paargumentuar në raport me parimin e sigurisë juridike si një nga parimet themelore të funksionimit të shtetit të së drejtës.

8. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (*shih vendimin nr. 43, datë 26.6.2015 i Gjykatës Kushtetuese*). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, që vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimin nr. 43, datë 26.6.2015 i Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin në shqyrtim, jam i mendimit se paragrafi i dytë i nenit 14 të ndryshuar, duke përcaktuar se *ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore nuk pezullon ekzekutimin e tij*, është i



paqartë dhe kontradiktor në raport me parashikimet e neneve 28–31 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në të cilat përcaktohet si rregull i përgjithshëm e drejta e pezullimit për shkak të ankimit gjyqësor. Edhe pse, sikurse konstaton edhe shumica (*shih paragrafin nr. 25 të vendimit të shumicës*), gjykata nuk ka asnjë pengesë që kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 29 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, të vendosë, si masë për sigurimin e padisë, pezullimin e aktit të nxjerrë nga këto organe, në këndvështrimin tim këto procedura kërkojnë kohë. Për rrjedhojë, heqja e së drejtës së pezullimit të aktit administrativ për shkak të ankimit gjyqësor nga formulimi i ri i paragrafit të dytë të nenit 14 të ligjit në fjalë krijon premisa reale për ndërmarjen e veprimeve arbitrare nga organet e zbatimit të ligjit. Këto organe stimulohen nga ky formulim për të ndërhyrë me shpejtësi në ekzekutimin e menjëhershëm të aktit administrativ duke shmangur gjykatën ose, e thënë ndryshe, duke i mohuar *de facto* të drejtën e ankimit efektiv individit.

10. Bazuar në sa më lart, mendoj se parashikimi i ri i nenit 14 të ligjit objekt shqyrtimi jo vetëm mbart rrezikun që pezullimi i vendimeve të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore të bëhet praktikisht i pamundur, por edhe krijon përplasje me dispozitat e ligjit nr. 49, datë 3.5.2012. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve të cilësuar (*shih vendimin nr. 43, datë 26.6.2015 i Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të mos krijojë në vetvete antikushetutshmëri, por kur paqartësia krijon probleme të tilla që çojnë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike, atëherë nuk mund të pranohet se këto norma janë të pajtueshme edhe me frymën e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 43, datë 26.6.2015 i Gjykatës Kushtetuese*).

12. Si përfundim, jam i mendimit se ka disa të drejta personale të lidhura ngushtë me sigurinë juridike të individit, për të cilat ligjvënësi, pavarësisht situatës shqetësuese të ndërtimeve në territorin e Shqipërisë, të cilat kanë diktuar ndryshimet në ligj (*shih propësimet e subjektit të interesuar, paragrafi 5.2 i vendimit të shumicës*), duhet të tregojë vetëpërmbytje. Për rrjedhojë, çmoj se parashikimi ligjor i paragrafit të dytë të nenit 14, të ligjit nr. 9870, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, ofron një zgjidhje që shkon në kundërshtim me qëllimin që synon ligjvënësi, sepse bie ndesh me parimet kushtetuese dhe si e tillë mund të çojë në cenimin e shtetit të së drejtës dhe të të drejtave dhe lirive të individit.

13. Për këto arsye, mendoj se paragrafi i dytë i nenit 14 i ligjit nr. 9870, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, duhej të shfuqizohej.

Anëtar: Vladimir Kristo



Aneksi nr. 2, pjesë e udhëzimit nr.3, datë 2.2.2016 i ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, “Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nëpërmjet vendosjes të një apo më shumë kodeve dydimensionale nga institucionet publike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, datë 15.2.2016



Aneksi 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
EMËRTIMI I INSTITUCIONIT

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Vendndodhja/dita/muaji/viti

**LËNDA: Vërtetim i kopjes në letër të dokumentit elektronik**

**VËRTETIM**

Bazuar në pikën 1/a, të nenit 10, të ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 3, datë 2.2.2016, “Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nëpërmjet vendosjes të një apo më shumë kodeve dydimensionale nga institucionet publike”, të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, me autorizimin nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ , lëshuar nga z./znj. \_\_\_\_\_, (titullari i institucionit) \_\_\_\_\_, vërtetoj se kjo kopje në letër është:

**“Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik”**

Titulli/Përshkrimi i dokumentit bashkëlidhur: \_\_\_\_\_

Numri i faqeve të dokumentit bashkëlidhur: \_\_\_\_\_ (me numra dhe shkronja)

I autorizuari:

(Emërtimi i Detyrës)

(Emri, Mbiemri)

(Nënshkrimi i personit të autorizuar)

(Vula e institucionit)

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë